

## ***ABSTRAKT***

### **MBROJTJA E PRONËSISË PËRMES PADISË PËR RIKTHIMIN E SENDIT NË POSEDIM TË PRONARIT; SFIDAT NË PRAKTIKËN GJYQËSORE**

Kandidatja: Liridona Palushi

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Haxhi Gashi

E drejta e pronësisë është e drejtë themelore e njeriut, e drejtë subjektive civile me karakter absolut. Mbrojtja e saj shtrihet si në aspektin e brendshëm ashtu edhe në aspektin ndërkombëtar, çka njëkohësisht e dëshmon edhe rëndësinë e saj.

Fokusi i këtij punimi është hulumtimi i mbrojtjes së pronësisë përmes padisë për rikthimin e sendit në posedim të pronarit; sfidat në praktikën gjyqësore. Padia për rikthimin e sendit në posedim të pronarit paraqet të drejtën e pronarit jo posedues, kundër poseduesit jo pronar, duke u mbështetur në kërkesën për rikthimin e sendit të tij në posedim të vetin. Ai është pronar, pra ka pushtetin juridik, por jo faktik, i cili për arsye jo objektive është privuar nga ushtrimi i autorizimeve të drejtës së pronësisë së tij. Qëllimi i këtij punimi konsiston në atë, që të tek lexuesit të ofrojë një pasqyrë të qartë rreth asaj, se si realizohet mbrojtja e pronësisë përmes kësaj padie në qoftë se pronari pengohet në ushtrimin e autorizimeve të tij, se cilat kushte duhet plotësuar apo çka duhet provuar pronari në procedurë për ta rikthyer sendin e tij në posedim.

Brenda punimit, përveç analizimit të rregullatives ligjore, rëndësi i kushtohet edhe rasteve gjyqësore, përkatësisht vendimeve të gjykatave, duke venë në pah disa nga sfidat e paraqitura, dhe njëkohësisht duke ofruar përgjigje se si kanë vendosur gjykatat e instancave të ndyshme lidhur me to.

Gjatë punës sime jam bazuar në: metodën e analizës së dispozitave ligjore, metodën e kërkimit doktrinar, metodën komparative (krahasuese), metodën e analizës së praktikës gjyqësore, metodën e anketimit dhe intervestimit të realizuar me gjyqtarë.

*Fjalët kyqe; padi, procedurë, pronësi, posedim, mirëbesim, keqbesim, mosparashkrim, sfidë, rikthim.*

## ***ABSTRACT***

### **PROPERTY PROTECTION THROUGH LAWSUIT FOR THE RETURN OF THE THING IN THE OWNER'S POSSESSION; CHALLENGES IN JUDICIAL PRACTICE**

Candidate: Liridona Palushi

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Haxhi Gashi

The right to property is a fundamental human right, a subjective civil right of absolute character. Its protection reaches out both in the internal and international aspect, which at the same time proves its importance.

The focus of this paper is the research of the property protection through lawsuit for the return of the thing in the possession of the owner; challenges in judicial practice.

The lawsuit for the return of the thing in the possession of the owner presents the right of the non-possessing owner, against the non-owner possessor, based on the request for the return of his thing in his own possession.

He is the owner, therefore he has the legal power, but not the factual (possession), which for non-objective reasons has been deprived of the exercise of the authorizations of his right of ownership. The purpose of this paper consists on providing readers with a clear overview of how the protection of property is realized through this lawsuit if the owner is hindered in exercising his authorizations, on what conditions must be fulfilled or what must be proven by the owner in the procedure to return his property (thing) in possession.

Within this research paper, apart of analyzing the legal regulations, importance is also given to court cases, respectively court decisions, highlighting some of the challenges presented, and at the same time providing answers to how the courts of different instances have decided on them.

During my research I relied on the: method of analysis of legal provisions, the method of research doctrine, the method of comparative, the method of analysis of judicial practice, the method of survey and interview conducted with judges.

*Keywords: lawsuit, procedure, property, possession, good faith, bad faith, non-prescription, challenge, return.*